



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

### RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Fatmir Krasniqi</b>	<b>26.11.2024</b>	<b>13.12.2024</b>	<b>2024/1131</b>
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
<b>liridon Gashi</b>	<b>04.12.2024</b>		

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.11.2024, OE “PRIMO STUDIO SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/1131, kundër njoftimit për rezultatet e jurise ku është vlerësuar me pikë shumë të larta kodit 4919”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Zhvillimi i projektit ideor dhe te hollesishem [zbatues kryesor], te arkitektures dhe te inxhinierise, per ndertimin e Stadiumit te ri ne Rahovec, ne perputhje me Kategorine II plus te rregulloreve dhe udhezimeve teknike per infrastrukture te stadiumeve, te miratuara nga UEFA. RITENDERIM” me nr. të prokurimit: "207-24-9503-2-2-3", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur Konkursit të Projektimit , lloji i kontratës, shërbim.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/1131 i dt:20.11.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji i Prokurimit Publik:

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “PRIMO STUDIO SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Rahovec, në përputhje me Kategorinë II plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA. RITENDERIM” me numër të prokurimit: “207-24-9503-2-2-3, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURËS RS DHE ÇJK

Neni 80 Perberja dhe Vendimet e Jurise

O Trajtimi i Dokumentacionit ne dy standarde per OE te ndryshme ofertese

O Eliminimi i nje OE per diqka qe i mungon edhe OE fituese.

· Rregullorja Nr.001/2022 per Prokurim Publik

Neni 55, Pika 55.26 Hapja dhe Vleresimi i Projekteve

## KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm.

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i jurise profesionale nuk ishte ngritur në platëformën e-prokurimi.

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

AK përmes CD-se, ka ofruar projektet ideore të dorëzuara nga kodet 1010 dhe kodi 4919.

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - PRIMO STUDIO SH.P.K.

### Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues –MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur Konkurs i Projektimit.

AK me dt. 11.09.2024 ka publikuar Njoftimin për kontratë, ndërsa të njëjtin e ka korigjuar me dt 03.10.2024 duke e bashkangjitur edhe dosjen e tenderit me ndryshime e bëra, vlenë të ceket fakti se ndaj ndryshimeve të bëra nga AK nuk kishte pasur asnjë ankesë nga OE. Hapje te ofertave nuk ka për shkak se ende nuk ka përfunduar faza e parë e vlerësimit. Vlejnë të ceket fakti se në bazë të procesverbalit të pranimit të ofertave, AK kishte pranuar gjithsej 5 oferta me kodet e caktuara.

AK- MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, me dt.31.10.2024 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku sipas jurisë profesionale kodi 4919 ka marrë 77 pikë nga gjithsej 80 sa ishin maksimumi i pikëve për përshkrim teknik, kurse kodi ankues 1010 ka marrë 55 pikë, nga gjithsej 80 sa ishin maksimumi i pikëve për përshkrim teknik.

Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala fillimisht parashtron kërkesë për Rishqyrtim tek AK me dt. 05.11.2024 brenda afatit ligjor. AK me dt. 12.11.2024 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pabazuar. Vlenë të ceket fakti se AK në vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, përveç se nuk i kishte arsyetuar pretendimet ankimore, poashtu AK nuk ka nuk e ka zbatuar nenin 63 par 3 të rregullores për prokurim publik nr. 001/22 pasi që vendimin e ka marrë ditën e 7 dhe bazuar në dëshmitë në platformën e-prokurimi nuk kishte njoftim për zgjatje të afatit nga ana e AK-së.

OE i pakënaqur me përgjigjen e AK-së me dt.20.11.2024 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime ankimore të njëjta.

### Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se pikënisja e problemit ka të bëjë me atë se OE ankues pretendon se Juria profesionale ka favorizuar kodin 4919 pasi që për situata të njëjta kete kod e ka vlerësuar me poena maksimale kurse oferten tonë e ka vlerësuar me pikë minimale, pra ka zbatuar standarte të dyfishta dhe shmangie nga detyra projektuese.

Eksperti Teknik dhe Shqyrtues sqarojnë se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, AK në dosjes së tenderit ka paraqitur detyren projektuese mbi bazën e së cilës është dashur të paraqesin propozimet e tyre OE.

**Më tej,** Eksperti teknik sqaronse; Pretendimet e OE ankues kundër AK-së janë :

#### - Mangësi në projektin e OE ankimor me kodin 1010

- Sipas 1.2. hapësira e ngrohjes, nuk mungon siç ka vlerësuar Komisioni. Pranohet pretendim i OE ankimor

- Sipas 1.5.1. të dhoma e zhvjeshtë nuk mungojnë 25 ulëse por janë të pandërprera. Meqë mungojnë dimensionet, është i vështirë vlerësimi i plotësimit të këtij kushti për hapësirës e nevojshme.

- Sipas 1.5.2. dhoma e zhvjeshjes për gjyqtarë, nuk mungojnë 6 ulëse por janë të pandërprera. Ndonëse mungojnë dimensionet, duket që OE 1010 e ka plotësuar këtë kusht, me stol ulës. Pranohet pretendimi i OE ankimor.

- Sipas 1.5.6. stacioni i kontrollit Doping është kërkuar të jetë AFER e jo LIDHUR.

- Sipas 1.6. te dhoma e zhvjeshjes për ndihmës nuk mungojnë 8 ulëse por janë të pandërprera. Ndonëse mungojnë dimensionet, duket që OE 1010 e ka plotësuar këtë kusht, me stol ulës. Pranohet pretendimi i OE ankimor.

- Sipas 2.2.1.1. biletaritë janë të ndara në 4 njësi dhe në 2 blloqe.

- Sipas 2.3.1. nuk mungon hapësira “bar me shërbime kafeje” Kati 1. Hapësira e emëruar 2.3.1. është evidentuar në Kati 1 (jug-lindje).

- Sipas 2.3.3. nuk ka ndarje të hapësirës. Hapësira 2.3.3. është evidentuar në Përdhesë, por e pa organizuar, andaj pranohet si pjesërisht i bazuar pretendimi ankimor.

- Sipas 2.4.1. nuk mungon hapësira “bar me shërbime ushqimi të lehtë” Kati 2. Hapësira e emëruar 2.4.1. është evidentuar në Kati 2, por e paorganizuar. Pranohet si i pjesërisht pretendimi ankimor.

- Sipas 2.4.2. janë hapësirat por të paorganizuara. Hapësira e emëruar 2.4.2. është evidentuar në Kati 2, por e paorganizuar. Pranohet si i pjesërisht pretendimi ankimor.

- Sipas 2.5.2. hapësirat sanitare për PAK në Përdhesë. Hapësira për PAK është evidentuar në Përdhesë. Pranohet si i bazuar pretendimi ankimor.

- Sipas 3.2. % 3.4. nuk mungojnë 10 ulëse me tavolina për media/gazetarë. Bazuar në projekt – kati 2, nuk është evidentuar hapësira 3.4. Hidhet si i pabazuar pretendimi ankimor.

- Sipas 3.5. nuk mungojnë hapësirat, janë në Kati 2. Hapësirat 3.5. janë evidentuar në Kati 2, por bazuar në vlerësimin e AK-së 3.6. nuk është sipas kërkesës. Pranohet si pjesërisht i bazuar pretendimi ankimor.

- Sipas 5.1. nuk mungojnë hapësirat e kontrollit teknik. Hapësirat janë të gjitha të ndërlidhura në nhapësirë të përbashkët – multi funksionale, me një hyrje dhe pa organizim. Hidhet poshtë pretendimi ankimor.

- Sipas 7. nuk mungon organizimi i jashtëm (është marrë parasysh pjerrtësia reale e terrenit). Vlerësimi është me bazë subjektive të secili anëtar, gjegjësisht është vlerësim i shijes konceptuale/vizuale.

#### **- Mangësi në projektin e OE të Rekomanduar me kodin 4919:**

- Mospërshtatje me lokacionin real. Nuk ka inçizim gjeodezik apo izohipsa në projekt në mënyrë që të konstatohet ky pretendim

- Nuk ka çasje të drejpërdrejt në fushë nga dhomat e zhveshjes për lojtarë. Pretendimi ankimor është i bazuar.

- Nuk ka çasje të drejtpërdrejt në fushë nga dhomat e zhveshjes për gjyqtarë. Pretendimi ankimor është i bazuar.

- Nuk ka çasje të drejtpërdrejt në fushë nga dhomat e delegatit. Pretendimi ankimor është i bazuar.

- Numri i ulëseve është 6454 nga 6500 i kërkuar. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

- Numri i kërkuar për ulëse të musafirëve të jetë 5% ( $6500 \cdot 0.05 = 325$ ) është 297 (për  $6454 = 323$ ). Bazuar në projektin e shqyrtuar pretendimi ankimor është i bazuar.

- Numri max i spektatorëve për hyrje duhet të jetë 600. Ndërsa për C1, C2 dhe C3 është 1994. Pretendimi ankimor është i bazuar.

- Numri max i spektatorëve për hyrje duhet të jetë 600. Ndërsa për D1 dhe D2 është 1340. Pretendimi ankimor është i bazuar.

- Numri max i spektatorëve për hyrje duhet të jetë 600. Ndërsa për B1 dhe B2 është 1340. Pretendimi ankimor është i bazuar.

- Sipas 2.3.3. kërkohej dyqane ëmbëlsirash. 4919 i mungojnë. Nga analiza e projektit nuk është gjetë hapësirë me këtë emër, as hapësirë me numër 2.3.3. Andaj, pretendimi ankimor konsiderohet se është i bazuar.

- Sipas 2.3.5. kërkohej veprimtari tregtare. 4919 i mungojnë. Nga analiza e projektit nuk është gjetë hapësirë me këtë emër, as hapësirë me numër 2.3.5. Andaj, pretendimi ankimor konsiderohet se është i bazuar.

- Sipas 2.5.1. kërkohej 1 tualet/15 spektatorë me aftësi të kufizuara. 4919 i mungojnë. Nje sanitare për PAK evidentohen në Përdhësë dhe Katë 1, andaj hidhet si i pasbazuar pretendimi ankimor.

- Sipas 3.2. kërkohej 20 ulëse për gazetarë (10 me tavolinë pune). 4919 i mungojnë. Hapësira është identifikuar në Katë 3, ka 8 tavolina pune, si dhe ka 20 ulëse tjera, që në tërësi janë 28 (në vend të 20).

Hapësira është e mjaftueshme për riorganizim, por në projektin e prezantuar nuk është bërë sipas kërkesës. Andaj, kjo pikë ankimore pranohet si pjesërisht e bazuar.

- Sipas 3.2. nuk janë vendosur në tribunë kryesore dhe të mbuluara nën strehë. Pretendimi ankimor është i bazuar.

- Sipas 5.4.1. VP 2 njësi për kamion/furgon. 4919 i mungojnë. Pretendimi ankimor është i bazuar.

- Sipas 6.6.1. VP 2 njësi për kamion/furgon. 4919 i mungojnë. Pretendimi ankimor është i bazuar.

- Sipas 2.7.2. VP 4 njësi për vetura të policisë. 4919 i mungojnë. Pretendimi ankimor është i bazuar.

- Sipas 3.6. Postet për intervistat e shpejta (4.0x3.0m). 4919 jo sipas dimensioneve. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “PRIMO STUDIO SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Rahovec, në përputhje me Kategorinë II plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA. RITENDERIM” me numër të prokurimit: “207-24-9503-2-2-3, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

\* OE me kodin 4919 në projekt nuk i ka emëruar hapësirat sipas emërimit të dosjes ose sipas numrit rendor të përcaktuar me detyrë projektuese, andaj kontrolli është i ndërlikuar dhe shkakton konfuzion.

Eksperti Teknik poashtu sqaron se, juria profesionale për vlerësimin e ofertave, se në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 par 4 të LPP-së pasi ka përdorur standard të dyfishtë të vlerësimit, kjo është identifikuar gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore. Në pjesën e Vlerësimit dhe komenteve për OE 1010, në pikën 5. komenti është se “nuk është specifikuar ndarja e hapësirave konform kërkesës së detyrës projektuese”, ndërsa për OE 4919, në pikën 5. të njëjtën situatë e ka vlerësuar si gabim të vogël teknik dhe e ka përfshirë te komentet për konsideratë.

Si përfundim, Eksperti shqyrtues dhe teknik vlerësojnë se AK, gjatë vlerësimit duhet ti përmbahet detyrës projektuese si kërkesa të domosdoshme të cilat janë në përputhje me natyrën e aktiviteti të prokurimit, kriterëve të dhënies së kontratës, me qëllim të mos bie ndesh me neni 7 të LPP-së dhe nenin 56 paragrafin 3 të LPP-së. **Prandaj, në bazë të konstatimeve të mësipërme vlerësojmë se pretendimet e palës në ankesë janë të qëndrueshme.**

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “PRIMO STUDIO SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Rahovec, në përputhje me Kategorinë II plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA. RITENDERIM” me numër të prokurimit: “207-24-9503-2-2-3, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **PRIMO STUDIO SH.P.K.**



**Fatmir Krasniqi**

**Iridon Gashi**